



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE
KOMISIONERI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE

Data: 03.03.2025

Nr: 226

Ora: 12:00

VENDIM

PËR

FILLIMIN E PROCEDURËS ADMINISTRATIVE BAZUAR NË DENONCIMIN NR. 48 ID, DATË 21.02.2025, TË REGJISTRIT TË DENONCIMEVE, TË PARTIA DEMOKRATIKE

Sot më datë 03.03.2025, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, pasi mori në shqyrtim paraprak denoncimin me:

KËRKUES: Partia Demokratike

SUBJEKT: **Z. Engjell Agaçi**
Sekretar i Përgjithshëm për Këshillin e Ministrave

OBJEKT: Konstatimi i kryerjes së veprimtarive të ndaluara, nga neni 91 i Kodit Zgjedhor dhe vendimi nr. 9/2020 i Komisionit Rregullator, konkretisht nxjerrja e akteve që synojnë dhënien e përfitimeve për kategori të caktuara të popullsisë dhe përdorimi i burimeve publike në mbështetje të subjekteve zgjedhore

BAZA LIGJORE: Neni 19, pikat 1, shkronjat “dh”, “f” dhe “n”, dhe 2, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, neni 8, pika 3, të vendimit nr. 9, datë 09.03.2021, të Komisionit Rregullator.

K O N S T A T O J :

Partia Demokratike më datë 21.02.2025, ka paraqitur në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve (KQZ) nëpërmjet adresës së postës elektronike e-mail, denoncimin e administruar në regjistrin e denoncimeve me nr. 48 ID.

Në këtë denoncim Partia Demokratike parashtron sa vijon:

“Partia Demokratike ka marrë dijeni se Kryeministri i vendit Edi Rama ka publikuar lajmin se në 1 mars 2025 do të nisë shpërndarjen e bonusit të pranverës për pensionistët. Kjo deklaratë e Kryeministrit është publikuar në mediat e vendit dhe nga vet Kryeministri në rrjetin e tij social

Data: 03.03.2025

Nr: 226
Ora: 12:00



“Për fillimin e procedurës administrative bazuar në denoncimin nr. 48 ID datë 21.02.2025, të regjistrin të denoncimeve, të Partia Demokratike/PD”

X. Deklarata e Kryeministrit është shoqëruar me publikimin e VKM nr. 20 të datës 9.1.2025 'Për mbështetjen financiare të pensionistëve për vitin 2025'. Partia Demokratike ngre shqetësimin dhe dyshimin se miratimi i këtyre akteve të cilat i drejtohen një kategorie të gjerë personash, siç janë pensionistët, para fushatës zgjedhore, të cilët përfaqësojnë mbi 650.000 shtetas, është një tentativë për të përfituar votat e këtyre zgjedhësve."

Nga sa më sipër çmoj se, ekzistojnë kushtet për t'u nisur hetimi administrativ.

PËR KËTO ARSYE:

Bazuar në nenin 19, pika 1, shkronjat "dh", "f" dhe "n", pika 2, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar, nenit 8, pika 3, të vendimit nr. 9, datë 9.3.2021, të Komisionit Rregullator në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve,

V E N D O S:

1. Fillimin e procedurës administrative ndaj:
-Z. Engjëll Agaçi, Sekretar i Përgjithshëm për Këshillin e Ministrave
2. Rezultatet e këtij vendimi i njoftohen palëve nëpërmjet adresës së postës elektronike.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të internetit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Ilirjan CELIBASHI